

EDUKIMI ËSHTË PRIORITETI YNË



LIRIA, FJALË ME KUPTIM TË MADH

ANESA (11), DORENTINA (11), ALTIN (11), DRILON (11), ANDI (10), ENIS (11)



Disa fakte dhe shembuj rreth demokracisë, sistemit më të mirë të qevrisjes

Artikullin do ta fillojmë duke iu treguar disa fakte rreth demokracisë. Demokracia do të thotë udhëheqje nga populli. Për herë të parë ajo është shfaqur në Athinë, në vitin 507 para erës sonë. Demokracia atëherë dhe sot ndryshon shumë.

Për dallim nga kohërat e lashta, kur të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm burrat e pasur, sot këtë të drejtë dhe të gjitha të drejtat e tjera i kanë të gjithë qytetarët pa dallim gjinie, race, etniciteti, etj. Në demokraci të drejtat e barabarta dhe liria janë elemente shumë të rëndësishme.

Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e lirisë në jetën tonë, grupi ynë vendosi që të shkruaj disa shembuj se si ne fëmijët ndihemi në një vend ku ka liri dhe të drejta të barabarta.

Fjala liri, fjalë me kuptim shumë të madh. Shpesh e dëgjojmë edhe ne fëmijët këtë fjalë. Për shembull,

Andi, Altini dhe Dorentina, kur dalin të luajnë në lagjen e tyre, mund të zgjedhin lojën që dëshirojnë të luajnë. Zakonisht ata luajnë futboll, por ndonjëherë edhe basketboll. Pra, ata janë të lirë dhe kanë të drejtë të zgjedhin lojën që ata dëshirojnë.

Anesa, Driloni edhe Enisi, shpesh diskutojnë tema të ndryshme, si për shembull, për filmat që i pëlqejnë. Ata gjatë diskutimit dëgjojnë dhe respektojnë mendimet e njëri-tjetrit, pavarësisht preferencave të tyre për film. Anesës i pëlqejnë më shumë filmat komedi, Drilonit i pëlqejnë më shumë filmat aksion, ndërsa Enisi i pëlqejnë më shumë filmat e frikshëm.

Gjatë diskutimit, ata ndjehen të lirë të shprehin mendimet e tyre. Kështu pra, në demokraci ne jemi të lirë, por duhet të jemi edhe të përgjegjshëm. Po ashtu, duhet të jemi tolerant dhe sa më bashkëpunues.

Nëse këtë liri e përdorim duke vepruar për të mirën e vendit, atëherë ardhmëria jonë do të jetë e ndriçuar, sikurse dielli kur lëshon rrezet e tij të arta.



Ne jemi „Piktorët e Demokracisë“



Kurse, ne jemi „Shkrimtarët e Demokracisë“

ME NEVOJA TË VEÇANTA DHE I BARABARTË

AJAN (11), ENDI (11), BLEND (10), ERIN (11), GRESA (10), LIBERTA (10), ELONITA (11)



Në procesin zgjedhor të drejtën për të votuar e gëzojmë të gjithë në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh aftësitë tona. Prandaj, unë Shpendi votoj si të gjithë të tjerët

Unë jam Shpendi, një qytetar i Republikës së Kosovës. Pas një aksidenti me veturë, unë përdor një karrocë, e cila më shërben për të lëvizur. Në shtetin tim, para disa muajve janë mbajtur zgjedhjet komunale. Prandaj, unë kisha dëshirë të votoj dhe të angazhohem



si të gjithë qytetarët e tjerë me këtë përgjegjësi. Por, mua më kufizonte paksa karroca për të shkuar deri në qendrën e votimit. Andaj, shokët e mi vendosën që të më ndihmonin të shkoja deri tek qendra ime e votimit. Kjo më bëri mua të lumtur, sepse atë ditë si të gjithë të tjerët edhe unë kisha rastin të votoj dhe të jap kontributin tim.

E gjitha kjo është falë demokracisë, e cila siguron të drejta të barabarta për të gjithë, qasje dhe mundësi të

njëjta. Raste të tilla kemi dëgjuar shumë shpesh, dhe ndihemi krenarë që edhe ne jemi pjesë e demokracisë, ku liria për të vepruar është e pakushtëzuar.

Andaj, qytetarë të dashur, udhëheqja e popullit është në duart tuaja, pa i dhënë rëndësi pamjes së jashtme, ngjyrës së lëkurës, vendit ku keni lindur, vendit ku jetoni tani apo aftësive tuaja fizike dhe mentale. Pesha e votës është e njëjtë për të gjithë qytetarët, sepse është vetëm një votë, e cila mund të bëj ndryshim të madh pa marrë parasysh se kush e jep atë.

E, meqenëse votimi në shtetin tonë Kosovën është përgjegjësi, bëhuni të përgjegjshëm dhe votoni. Ju për ne e ne për ju.

Kështu ndërtohet shteti demokratik. Me qytetarë të mirë dhe të arsimuar formohet shteti i mirë që e ëndërrojnë të gjithë. Me ndihmën e përbashkët mund të bëjmë çudira, andaj ejani dhe na ndihmoni, për të mirën e të gjithëve.



Jemi krenarë me punën tonë



Shteti im më ofron shumë të drejta. Andaj, çdo herë dua të jem i përgjegjshëm për veprimet e mia



Sot jam në proces të fitimit të njohurive, e nesër do t'i shërbej krejt popullit tim



E kur të mbush moshën 18 vjeçare, përveç se do të votoj, do të kandidoj edhe për deputet



Unë kam vizion të qartë se si dua të kontribuoj për shtetin dhe popullin tim në të ardhmen



Planprogramin tim do ta shkruaj duke i marrë parasysh të gjitha nevojat dhe kërkesat e qytetarëve



Kuvendi duhet të përbëhet nga deputetë të përkushtuar dhe shumë punëtorë

AKTIV PËR TË MIRËN E TË GJITHËVE

ARLIND (10), LEON (11), OLTİ (10), SHERIF (11), LIJANA (11), ANISA (11)



Dëshironi të mësoni më shumë se si mund të jemi aktiv në vendin tonë? Nëse po, ky është artikulli i duhur për ju

Festa e 28 nëntorit është një festë shumë e dashur për të gjithë shqiptarët. Vitin që shkoi, disa nxënës të shkollës sonë, pikërisht për këtë festë, janë mbledhur për të dekoruar qytetin e Gjilanit. Ata në mënyrë vull-



netare zbukuruan qytetin tonë me ngjyra kuq dhe zi. Të gjithë qytetarët e Gjilanit ishin të mrekulluar me punën e këtyre nxënësve. Pjesa më e bukur e gjithë kësaj është se nxënësit e shkollës sonë e kishin bërë tërë këtë punë në mënyrë vullnetare. Ata kanë shprehur dëshirën të jenë aktiv. Në këtë mënyrë, të gjithë kemi përfituar nga aktivizimi i tyre. Ndërsa një grup tjetër i fëmijëve nga Gjilani kanë pastruar parkun e qytetit. Kjo quhet qytetari aktive.

Secila iniciativë që merret nga qytetarët e Kosovës për

të bërë diçka të mirë për vendin e tyre, është qytetari aktive. Pjesëmarrja në zgjedhje, në tubime dhe protesta paqësore, nënshkrimi i peticioneve, puna vullnetare, janë vetëm disa nga mënyrat se si ne mund të jemi aktiv në vendin tonë.

Meqë jetojmë në demokraci, sigurisht se ne qytetarët kemi shumë të drejta. Disa nga këto të drejta janë: e drejta e votës, e shprehjes së lirë, e shkollimit, e argëtimit, e familjes, etj. Këto të drejta i gëzojmë të gjithë, pa asnjë dallim fetar, racor, etnik apo ndonjë dallim tjetër. Gjithsesi, ne kemi edhe përgjegjësi ndaj vendit tonë. Numërojmë: respektimin e ligjit, ruajtjen e pronave publike, ruajtjen e ambientit, pagimin e taksave, etj. Ne shpresojmë se ky artikull iu ka bërë të reflektoni dhe ta kuptoni se ne qytetarët jemi ata të cilët e formojmë, e ruajmë dhe e mbrojmë vendin tonë. Këtë mund ta bëjmë vetëm duke qenë aktiv.



Për herë të parë si gazetarë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Sadulla Brestovci“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan